



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPKI</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>06/2307/20</u>
Nr. i faq. Broj stranic <u>03</u>	Data Datum <u>20-10-2020</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 16.10.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti Nr. AKK-DPKI-06-1349/19, për zyrtarin z. Florim Shefqeti, Drejtor Ekzekutiv i Odës së Avokatëve të Kosovës, pasi që i njëjti ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i detyrave të Prokurorit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Florim Shefqeti, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga një palë e tretë, me pretendimin për konflikt të interesit pasi që z. Florim Shefqeti, Drejtor Ekzekutiv i Odës së Avokatëve të Kosovës (në vijim: OAK), njëkohësisht është edhe u. d. Prokuror Disiplinor në OAK.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-1565/20, e ka njoftuar zyrtarin lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç'rast z. Florim Shefqeti është njoftuar me faktet që posedon Agjencia sa i përket pretendimit për konflikt të interesit lidhur me ushtrimin e dy funksioneve njëkohësisht brenda OAK-së.

Së këndejmi, ushtrimi i detyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së nga z. Florim Shefqeti, është në papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit Drejtor Ekzekutiv i OAK-së. Kjo për faktin se sipas Rregullores për marrëdhënien e punës, sistemimin e vendeve të punës dhe detyrat e punës, pagat

dhe beneficionet e punës, përgjegjësitë disiplinore të administratës së OAK-së të datës 27.02.2017, pozita e Drejtorit Ekzekutiv të OAK-së dhe pozita e Prokurorit Disiplinor të OAK-së janë pozita të veçanta. Kjo është përcaktuar me dispozitën e nenit 26 pika a) të kësaj Rregulloreje me të cilën përcaktohet se: *“Në kuadër të OAK ekzistojnë këto vende të punës: Drejtor Ekzekutiv, [...], Prokuror Disiplinor [...]”*. Për më tepër, me nenin 10 të kësaj Rregulloreje është përcaktuar se: *“Drejtori Ekzekutiv i OAK mbikëqyrë punën e stafit dhe vendos në lidhje me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësinë e punëtorëve duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret”*.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe në dispozitat që përcaktojnë detyrat e punës së Drejtorit Ekzekutiv (neni 33) dhe detyrat e punës së Prokurorit Disiplinor (neni 35), konstatohet se pozita e Prokurorit Disiplinor të OAK-së është pozitë vartëse e pozitës së Drejtorit Ekzekutiv të OAK-së. Kështu, ushtrimi i detyrave të Prokurorit Disiplinor nga Drejtori Ekzekutiv i OAK-së, e pamundëson kontrollin dhe mbikëqyrjen e Prokurorit Disiplinor nga Drejtori Ekzekutiv. Edhe pse me Rregullore janë përcaktuar si dy pozita të veçanta, njëra është vartëse e tjetrës, faktikisht në rastin e z. Florim Shefqeti raporti i varësisë së dy pozitave në fjalë nuk ekziston, sepse ai si Drejtor Ekzekutiv ushtron edhe detyrat e Prokurorit Disiplinor.

Zyrtari z. Florim Shefqeti, në takimin e mbajtur ka pranuar se është Drejtor Ekzekutiv i OAK-së dhe njëkohësisht është duke ushtruar, përkohësisht, detyrën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së. Por ka deklaruar se detyrën e Prokurorit Disiplinor e ushtron vetëm si detyrë shtesë, sipas autorizimit të Këshillit Drejtues të OAK-së, deri në zgjedhjen e Prokurorit Disiplinor nga OAK-ja. I njëjti ka theksuar se nuk kompensohet për ushtrimin e detyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së, si detyrë shtesë.

Për të vërtetuar deklaratën e tij, z. Florim Shefqeti ka dërguar në Agjenci Vendimin e Këshillit Drejtues të OAK-së V. Nr. 41/2018, të datës 14.01.2018. Me pikën I. të këtij Vendimi, përcaktohet se Këshilli Drejtues i OAK-së ka aprovuar njëzëri propozimin e komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e z. Florim Shefqeti në pozitën Drejtor Ekzekutiv i OAK-së. Ndërsa me pikën II. të Vendimit në fjalë, përcaktohet se Këshilli Drejtues i OAK-së ka autorizuar z. Florim Shefqeti që të trajtoj dhe të përfaqësoj Zyrën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së për lëndët disiplinore, deri në zgjedhjen e Prokurorit Disiplinor të OAK-së.

Megjithatë, OAK-ja ende nuk ka zgjedhur Prokurorin Disiplinor edhe pse, në bazë të informatave që janë publikuar në uebfaqen zyrtare të OAK-së, më datë 05.02.2019 ka shpallë, ndërsa më datë 30.05.2019 ka ri-shpallë, konkurs për vend të lirë të punës në pozitën Prokuror Disiplinor.

Dispozitat e nenit 19 të LPKI-së përcaktojnë se: *“1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave: [...] 1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik; 1.4. dorëhiqet nga funksioni publik”*.

Andaj, në shtjellim të dispozitave dhe situatës së mësipërme, Agjencia ka kërkuar nga z. Florim Shefqeti të shmang gjendjen e papajtueshmërisë në rastin e ushtrimit të detyrave të Prokurorit Disiplinor të OAK-së duke qenë njëkohësisht Drejtor Ekzekutiv i OAK-së. Zyrtari z. Florim Shefqeti, ka deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete, në mënyrë që të lirohet nga ushtrimi i detyrës së Prokurorit Disiplinor, konform kërkesës dhe udhëzimeve të Agjencisë.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën (DPKI-06-2230/20) me të cilën dëshmohet se Këshilli Drejtues i OAK-së ka aprovuar kërkesën e z. Florim Shefqeti për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së. Pas analizimit të dokumentacionit të pranuar nga zyrtari, Agjencia konstatoi se z. Florim Shefqeti, ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi detyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.3 të LPKI-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

